



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

STRATEGJIA PËR AVOKIM E ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVË DHE PROFESIONISTËVE TË TJERË SHËNDETËSORË

2025 – 2029

Shkurt 2025

Ky dokument është përgatitur dhe publikuar me mbështetje nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes projektit Shërbime Shëndetësore të Integruara (IHS), një nismë e përbashkët me Ministrinë e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, që zbatohet nga Instituti Zviceran për Shëndet Publik dhe Tropikal (Swiss TPH). Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të Tjerë Shëndetësorë dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimet e SDC-së



**Integrated
Health
Services**

SDC project implemented by Swiss TPH



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



STRATEGJIA PËR AVOKIM E ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TË TJERË SHËNDETËSORË

2025 – 2029

HYRJE

Mjedisi i kujdesit shëndetësor në Kosovë është kompleks dhe dinamik, dhe roli i infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë të kujdesit shëndetësor është bërë shumë i rëndësishëm për të siguruar kujdes shëndetësor cilësor. Këta profesionistë janë në vijën e parë të kujdesit ndaj pacientëve dhe luajnë një rol vendimtar në promovimin e shëndetit, parandalimin e sëmundjeve dhe ruajtjen e një shëndeti të mirë fizik dhe mendor në popullatë.

Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë (OIK) është e përkushtuar që t'i përfaqësojë dhe avancojë në mënyrë efektive interesat e anëtarëve të saj dhe t'i adresojë sfidat me të cilat përballlet sektori i kujdesit shëndetësor, duke avokuar për politika që rrisin shëndetin dhe mirëqenien e komunitetit. Kjo Strategji e Avokimit synon të ofrojë një qasje të strukturuar për të ndikuar efektivisht në politikat e kujdesit shëndetësor, për t'i adresuar sfidat dhe për të promovuar vlerën e infermierisë dhe mamisë.

Strategjia pesëvjeçare e Avokimit e OIK–ut do të fokusohet në tri objektiva kryesore: fuqizimi i pozitës dhe rolit të infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë për të ofruar kujdes cilësor, ndikimi në ndryshimin e politikave për përmirësimin e kushteve që kanë prioritet qëndrueshmërinë dhe dinjitetin e profesionistëve shëndetësorë për të pasur sukses në mjediset e tyre, si dhe promovimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të palëve të interesit dhe publikut të gjerë për vlerën e këtyre profesioneve dhe rolin thelbësor të profesionistëve shëndetësorë.

Strategjia do t'i trajtojë sfidat e profesionistëve të kujdesit shëndetësor. Ndërsa kërkesa për shërbime shëndetësore vazhdon të rritet, është thelbësore të sigurohet që të jenë të pajisur me burimet, trajnimin dhe mbështetjen e nevojshme për t'i përmbushur këto kërkesa. Duke avokuar për politika që kanë prioritet zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë të kujdesit shëndetësor, Oda synon të krijojë një mjedis ku profesionistët e kujdesit shëndetësor do të kenë sukses në misionin e tyre.

Angazhimi me palët kryesore të interesit, përfshirë vendimmarrësit dhe politikëbërësit, institucionet partnere, organizatat e kujdesit shëndetësor, mediat dhe publikun, do të ngrëjë zërin e unifikuar të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe do të nxjerrë në pah kontributin e tyre thelbësor në sistemin e kujdesit shëndetësor në vend, për të siguruar që ekspertiza dhe njohuritë e tyre të integrohen në proceset vendimmarrëse.

Përmes iniciativave të targetuara, partneriteteve strategjike dhe shtrirjes tek komuniteti, OIK–u synon të adresojë çështje të rëndësishme siç janë kufizimet në kornizën ligjore, zhvillimin profesional dhe integrimin e praktikave inovative në kujdesin ndaj pacientëve.

Për më tepër, Oda kërkon të promovojë vlerën e infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë të kujdesit shëndetësor përmes fushatave të ndërgjegjësimit të publikut dhe nismave të angazhimit të komunitetit. Duke theksuar kontributin e rëndësishëm të këtyre profesionistëve, kjo strategji do të nxisë një vlerësim më të madh për rolet e tyre në sistemin e kujdesit shëndetësor.

Strategjia për Avokim për Odën e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë në Kosovë 2025–2029

Ky dokument është hartuar me mbështetjen e projektit IHS. Përmbajtja e tij është rezultat i grupit punues të OIK–ut si dhe ekspertizës së ofruar nga ekspertja e jashtme e angazhuar nga Projekti, Klevis Vaqari.

Kontribues: Grupi punues për zhvillimin e Strategjisë për Odën e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë në Kosovë 2025–2029, i kryesuar nga kryetarja e OIK–ut, znj. Nexhmije Gori, dhe i përbërë nga nënkryetarët e OIK–ut, Këshilli Drejtues dhe kryetari i tij, përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë, përfaqësuesit e Organeve të Odës dhe Shërbimi Profesional si dhe ekipi i projektit IHS.

Autor: Klevis Vaqari

Parathënie e Kryetares së OIK–ut



Nexhmije Gori

Kryetare e Odës së Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë (OIK)

Jam shumë e lumtur që kam mundësi të paraqes para jush këtë strategji të rëndësishme për avokimin dhe Planin e Veprimit, të hartuar me ndihmën e projektit “Shërbime Shëndetësore të Integruara” (ang. Integrated Health Services) (IHS), që mbetet njëri nga partnerët shumë të çmuar të Odës së Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë (OIK).

Kjo Strategji si dhe Plani i Veprimit kanë për qëllim fuqizimin dhe angazhimin OIK–ut në mbrojtjen e interesave profesionale të anëtarëve të tij si dhe në përmirësimin e mundësive për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Strategjia dhe Plani i Veprimit do të shërbejnë si një udhërrëfyes për zhvillimin e aktiviteteve dhe nismave që synojnë rritjen e ndikimit të OIK–ut në proceset vendimmarrëse dhe promovimin e përfshirjes aktive të profesionistëve shëndetësorë në politikat shëndetësore.

Për t'i arritur këto qëllime, Strategjia dhe Plani i Veprimit fokusohen në tri objektiva kryesore:

- 1. Ndërtimi dhe forcimi i kapaciteteve në OIK–ut** – Pjesë kyçe e Strategjisë është rritja e kapaciteteve brenda OIK–ut, për të mundësuar një organizatë më të fuqishme për realizimin e misionit të saj. Kjo përfshin trajnime të vazhdueshme për anëtarët, zhvillimin e aftësive menaxheriale dhe rritjen e mundësive për përfshirje të anëtarëve në proceset vendimmarrëse.
- 2. Përmirësimi i kornizës ligjore** – Një nga prioritetet kryesore është të ndikojmë në përmirësimin dhe modernizimin e kornizës ligjore që rregullon profesionet shëndetësore. Kjo do të mundësojë krijimin e kushteve më të mira për profesionistët dhe një mbrojtje të fortë ligjore për të drejtat e tyre.
- 3. Ngritja e kapaciteteve në fushën e komunikimit, duke përfshirë informimin dhe edukimin publik për rolin e OIK–ut** – Një aspekt thelbësor i Strategjisë është rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik për rëndësinë e profesionistëve shëndetësorë në shoqëri. Përmes fushatave informative dhe edukative, synojmë të rrisim vlerësimin për rolin e infermiereve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë, duke kontribuar kështu në një sistem shëndetësor më të qëndrueshëm.

Strategjia që po paraqesim bashkë me Planin e Veprimit janë rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë me ekspertë dhe organizata me kontribut të jashtëzakonshëm në fushën e shëndetësisë dhe avokimit, të cilët kanë kontribuar me njohuri dhe përvojë për të krijuar një plan veprimi të qartë dhe të qëndrueshëm.

Ky plan është orientuar nga nevoja për t'i përforcuar kapacitetet tona të avokimit dhe për të ndihmuar në adresimin e çështjeve kyçe që prekin profesionistët dhe shërbimet shëndetësore në përgjithësi.

Besojmë se ky dokument do të shërbejë si një burim frymëzimi dhe udhëzimi për të gjithë ata që janë të angazhuar në këtë mision të rëndësishëm dhe do të kontribuojë në forcimin e rolit të infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë.

KONTEKSTI

Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë është themeluar si një organizatë e pavarur profesionale, në bazë të Ligjit nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, miratuar në vitin 2013. Kompetencat e plota, siç parashikohen nga nenet 9 dhe 10 të këtij ligji, i kaluan OIK–ut në vitin 2017, duke i lejuar Odës të marrë përgjegjësinë e vetorganizimit dhe operimit. Përkundër zhvillimit dhe fuqizimit të mekanizmave që rregullojnë funksionimin e Odës, ajo përballet me disa sfida që ndikojnë dukshëm në efektivitetin e saj dhe përfaqësimin adekuat të interesave të anëtarëve të saj.

Në vitin 2021, Kosova filloi procesin e rishikimit të Ligjit për Shëndetësi. Megjithatë, ndryshimi i ligjit ende nuk ka përfunduar. Projektligji për Shëndetësinë, i prezantuar në tetor të vitit 2024, synon centralizimin e kompetencave aktuale të të gjitha odave, që është ndër reformat më të mëdha në sistemin e kujdesit shëndetësor, duke mundësuar vetadministrimin e profesionistëve të shëndetësisë përmes odave përkatëse, në përputhje me praktikat e vendeve të Bashkimit Evropian dhe më gjerë. Ky projektligj është në kundërshtim me standardet evropiane dhe si i tillë shprehet vetëm në vende si Bjellorusia, Hungaria, Turqia dhe Sllovakia. OIK–u duhet të koordinohet ngushtë dhe intensivisht me odat e tjera, në mënyrë që të bëhet pjesë thelbësore e diskutimit në lidhje me përmbajtjen e projektligjit.

Kosova nuk ka një ligj të veçantë, të dedikuar ekskluzivisht për infermierët. Në vend të kësaj, praktika e infermierisë rregullohet me Ligjin më të gjerë për Shëndetësinë. Fuqizimi i Odës për të avokuar dhe angazhimi i duhur në proceset e formësimit të politikave dhe përmirësimit të kornizës aktuale ligjore, është thelbësor për të siguruar që profesionistët e kujdesit shëndetësor të përfaqësohen dhe të përmbushen interesat e tyre. Ekziston një nevojë urgjente që Oda të forcojë rolin e saj në proceset e hartimit të legjislacionit, veçanërisht për të nxitur fillimin e procesit të hartimit të Ligjit për Infermierët, i cili në mënyrë specifike do t'i adresojë rolet, përgjegjësitë dhe standardet për infermierët dhe do të përmirësojë kornizën profesionale për infermierinë në Kosovë.

Kosova aktualisht nuk ka një sistem gjithëpërfshirës të klasifikimit të vendeve të punës posaçërisht për profesionistët shëndetësor, duke përfshirë infermierët dhe mamitë. Korniza e përgjithshme ekzistuese për kategorizimin e roleve brenda sistemit të kujdesit shëndetësor nuk është në përputhje me legjislacionin e BE–së, siç është Direktiva e BE–së për njohjen e kualifikimeve profesionale. Një sistem klasifikimi i vendeve të punës që përcakton qartë rolet e ndryshme të kujdesit shëndetësor dhe kualifikimet, përgjegjësitë dhe rrugët e karrierës së tyre përkatëse nuk është zhvilluar ende. Për profesionistët e kujdesit shëndetësor, përputhja me legjislacionin dhe direktivat e BE–së është thelbësore për të siguruar aftësinë e tyre për të punuar në vendet e BE–së, pasi ato përcaktojnë standardet për njohjen e kualifikimeve dhe mënyrën se si ato mund të validohen. Ky proces mbetet thelbësor për t'i harmonizuar rregulloret e vendit me standardet e BE–së, për të lehtësuar mobilitetin dhe për të siguruar që profesionistët e kujdesit shëndetësor nga Kosova të mund të operojnë efektivisht brenda Bashkimit Evropian.

Shumë profile të kujdesit shëndetësor të akredituara nga Agjencia Kosovare e Akreditimit apo të marra jashtë vendit nuk njihen nga Ministria e Shëndetësisë pasi nuk janë të përditësuara në Ligjin për Shëndetësi. Kjo mospërputhje çon në sfida për aplikantët, duke rezultuar në pengesa që ata të marrin licencat përkatëse të

punës dhe të ushtrojnë profesionin e tyre. Si rrjedhojë, nganjëherë aplikimet për licencimin e anëtarësimit refuzohen nga OIK-u, duke theksuar nevojën për krijimin e menjëhershëm të një mekanizmi të koordinuar që përfshinë Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Agjencinë Kosovare të Akreditimit, për t'i adresuar këto çështje.

OIK-ut aktualisht i mungojnë dëshmitë e strukturuar për t'i dokumentuar të gjitha këto çështje të reja që prekin anëtarët e tij, kufizimet në kornizën aktuale ligjore dhe nevojat e profesionistëve të kujdesit shëndetësor, gjë që kufizon aftësinë për t'i informuar iniciativat avokuese. Dokumentimi i kufizimeve në legjislacion dhe praktikën e kujdesit shëndetësor dhe pasojat e tyre, së bashku me praktikën më të mira që rrjedhin nga vende të tjera dhe rekomandimet specifike për përmirësime, janë thelbësore për t'i nxitur iniciativat e avokimit. Më tej, përmirësimi i strategjive të komunikimit është jetik për të siguruar që temat përkatëse të kenë prioritet në debatin publik dhe agjendat e politikave.

Ndërsa OIK-u organizon aktivitete dhe komunikime për anëtarët e tij, kontakti aktual i mungon thellësia dhe angazhimi. Një strategji komunikimi më e fortë është e nevojshme për të arritur tek partnerët, palët e interesit dhe publiku i gjerë, duke siguruar që kontributet e profesionistëve të kujdesit shëndetësor të njihen. Publikimet e rregullta dhe rritja e prezencës në rrjete sociale dhe e funksionalitetit të uebfaqes me përmbajtje multimediale dhe veçori ndërvepruese do të ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e besueshmërisë ndaj Odës si një zë i unifikuar dhe i besuar në kujdesin shëndetësor.

OIK-u ka mundësi të zgjerojë bashkëpunimin me lidhje të reja, si me organizatat kombëtare ashtu edhe me ato ndërkombëtare, për të marrë mbështetjen e nevojshme në aktivitetin avokues. Këto partneritete mund të lehtësojnë shkëmbimin e praktikave më të mira, t'i përmirësojnë standardet dhe potencialisht t'i rrisin burimet e OIK-ut.

Për pavarësi financiare, OIK-u mbështetet kryesisht në tarifat e anëtarësimit dhe pagesat e licencimit. Megjithatë, aktivitetet e tij komplekse kërkojnë burime shtesë për të mundësuar një avokim të qëndrueshëm dhe të mirë informuar. Mbledhja e fondeve mund t'i rrisë burimet njerëzore, të gjenerojë të ardhura të reja dhe të mbështesë zbatimin e programeve dhe aktiviteteve në përputhje me mandatin e OIK-ut.

MISIONI I OIK–ut

Misioni i Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë është mbrojtja dhe prezantimi i interesave profesionale të anëtarëve të saj, sigurimi i standardeve të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovimi dhe mbrojtja e veprimtarisë së profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike dhe ato private, sigurimi i edukimit të vazhdueshëm profesional për ofrimin e shërbimeve shëndetësore sa më cilësore dhe shërbimeve të tjera që lidhen me kujdesin shëndetësor të popullatës në ruajtjen e kujdesit shëndetësor.

VIZIONI I OIK–ut

Vizioni i Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë është të jetë një institucion lider që frymëzon ekselencë për anëtarët e saj, duke garantuar standardet më të larta të kujdesit dhe duke ndërtuar besimin e publikut përmes qeverisjes efektive, efikase, transparente dhe të përgjegjshme dhe përmes ofrimit të shërbimeve profesionale. Oda synon të ofrojë zhvillimin profesional dhe të jetë forcë shtytëse në avancimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor, duke avokuar për të drejtat dhe përgjegjësitë e profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore me cilësi të lartë për të gjithë qytetarët.

QËLLIMI I STRATEGJISË SË AVOKIMIT

Të avancojë pozicionin e Odës në ndikimin e proceseve legjislativë dhe ndërgjegjësimin e publikut për rolin dhe rëndësinë e infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë të kujdesit shëndetësor, për ofrimin e shërbimit shëndetësor cilësor për qytetarët.

MESAZHET E AVOKIMIT

- Infermierët e bashkuar, një forcë për ndryshim
- Së bashku për shëndetin, së bashku për ndryshim
- Heronjtë e shëndetësisë, më të fortë së bashku
- Së bashku për kujdes shëndetësor cilësor
- Së bashku për kujdesin ndaj pacientit, së bashku për shëndetin
- Të bashkuar për kujdesin ndaj pacientëve
- Profesionistë shëndetësorë, që kujdesen për çdo pacient
- Kujdesi për komunitetin tonë, duke mbështetur mirëqenien
- Kampionimi i shëndetit, fuqizimi i njerëzve
- Së bashku për një popullsi më të shëndetshme
- Kujdes shëndetësor për të gjithë, sepse shëndeti është e drejtë
- Profesionistë shëndetësorë të bashkuar, avokues të shëndetit
- Për komunitete më të shëndetshme, për të ardhme më të shëndetshme
- Promovimi i kujdesit, fuqizimi i jetëve
- Profesionistë të vijës së parë, të përkushtuar ndaj kujdesit

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE:

Objektivi 1: Ndërtimi dhe fuqizimi i kapaciteteve dhe aftësive të OIK–ut për të avokuar në mënyrë efektive për mbrojtjen e interesave të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe avancimin e rolit dhe pozitës së tyre në sektorin e kujdesit shëndetësor.

Objektivi 2: Të kontribuojë në përmirësimin dhe avancimin e kornizës ligjore që prek interesin e profesionistëve shëndetësorë, përmes rritjes së ndikimit në proceset e vendimmarrjes dhe formësimit të politikave.

Objektivi 3: Rritja e informimit dhe edukimit të publikut mbi rolin vendimtar të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe rëndësinë e tyre në sigurimin e shëndetit dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve.

HARTËZIMI I PALËVE TË INTERESIT DHE PLANI I ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT:

Në kontekstin e përpjekjeve avokuese të OIK–ut, hartëzimi i palëve të interesit është një proces shumë i rëndësishëm dhe strategjik për të mundësuar identifikimin, analizimin dhe priorizimin e individëve, grupeve dhe organeve që lidhen ngushtë me qëllimet e Strategjisë së Avokimit dhe janë vendimtare për t'u trajtuar gjatë gjithë zbatimit të saj. Në faza të ndryshme të zbatimit të Strategjisë, këto palë të interesit mund të ndikojnë ose të ndikohen nga aktivitetet dhe qëllimet e saj. Prandaj, kategorizimi i kujdesshëm i palëve të interesit bazuar në ndikimin dhe interesin e tyre në këtë fushë është thelbësor për të vlerësuar ndikimin që ato mund të kenë në faza të ndryshme të zbatimit të aktiviteteve të avokimit të OIK–ut dhe se si mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të Strategjisë.

Zhvillimi i hartëzimit të palëve të interesit ndihmon për t'i kuptuar më mirë grupet e ndryshme të palëve të interesit dhe pozicionin e tyre ndaj objektivave të Strategjisë, siç janë grupet e mbështetësve, palët e interesit neutrale ose ato kundërshtarë. Ky proces informon rreziqet që mund t'i hasë zbatimi i Strategjisë, strategjitë e ndryshme për t'i kapërcyer këto rreziqe dhe për të siguruar sukses, si dhe mesazhet që mund të zhvillohen për t'i adresuar pozicionet e secilit grup, për të ndikuar siç duhet në rezultatet e pritura të Strategjisë.


Për të zhvilluar një hartëzim gjithëpërfshirës dhe të dobishëm të palëve të interesit, hapi i parë është renditja e të gjitha palëve potenciale të interesit që janë vazhdimisht ose në një moment të rëndësishëm për zbatimin e Strategjisë së Avokimit të Odës. Palët më relevante të interesit të identifikuara, që janë të rëndësishme për t'u analizuar në mënyrë që të angazhohemi me secilën prej tyre në mënyrën e duhur për arritjen e objektivave të avokimit, janë:

- Ministria e Shëndetësisë;
- Qendra Klinike Universitare e Kosovës;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Kuvendi i Kosovës;
- Anëtarët e OIK–ut;
- Presidenca e Kosovës;
- Agjencia Kosovare e Akreditimit;
- Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë;
- Zyra e Kryeministrit;
- Organizatat e Shoqërisë Civile;
- Universiteti i Prishtinës;
- Media;

- Donatorët;
- Institucionet e edukimit shëndetësor në nivel fillor, të mesëm dhe terciar;
- Shoqatat profesionale;
- Koordinatorët rajonalë.

Hapi i dytë i këtij procesi është analiza dhe vlerësimi i fuqisë dhe interesit të secilës palë të interesit përmes një hartëzimi (mapping) të palëve të interesit, për të përcaktuar pozicionin e tyre të përgjithshëm mbi çështjet e trajtuara nga Strategjia për Avokim e OIK–ut dhe për të përshtatur angazhimin me secilën prej tyre. Hartëzimi i palëve të interesit është një përfaqësim i secilës prej palëve të interesit të listuara, bazuar në nivelin e fuqisë/ndikimit që ato kanë në çështjet thelbësore të trajtuara nga OIK–u dhe nivelin e interesit/përfshirjes në veprimtarinë dhe iniciativat e Odës. Kjo analizë e ndihmon OIK–un të kuptojë më mirë këto palë të interesit, ndikimin e tyre dhe të zhvillojë një strategji për menaxhimin e palëve të interesit, në përputhje me rrethanat.

Matrica e fuqisë/interesit është një kornizë strategjike e përdorur për t'i kategorizuar palët e interesit në katër kuadrate bazuar në dy faktorë kryesorë, fuqinë e tyre për të ndikuar në një çështje dhe nivelin e tyre të interesit në rezultatet e saj.



Hartëzimi i palëve të interesit, i elaboruar më sipër, ofron një klasifikim të palëve të interesit në katër kuadrate të ndryshme që informojnë edhe për llojin e marrëdhënies, komunikimin dhe shpeshësinë e shkëmbimit me çdo palë të interesit:

Fuqi e lartë/interesi i lartë: Palët e interesit në këtë kuadrat janë vendimtare për përpjekjet e avokimit për shkak të ndikimit të rëndësishëm që kanë në proceset kyçe. Ato duhet të menaxhohen nga afër, dhe të angazhohen rregullisht dhe në mënyrë aktive përmes takimeve, informimeve të rregullta dhe nismave të përbashkëta, dhe duhet të konsiderohen si palë kryesore të interesit për t'i koordinuar dhe shtyrë përpara përpjekjet e avokimit. Siç mund të kuptohet nga matrica, institucionet si Ministria e Shëndetësisë, Ministria e

Arsimit, Zyra e Kryeministrit apo Agjencia Kosovare e Akreditimit, janë palët kryesore të interesit për shkak të fuqisë së tyre të lartë për t'i prioritetizuar dhe udhëhequr proceset legjislative dhe politike që janë relevante për punën dhe veprimtarinë e Odës.

Fuqi e lartë/interesi i ulët: Këto palë të interesit kanë fuqi ose autoritet të lartë për të ndikuar në procese, por nuk janë të interesuara drejtpërdrejt në rezultatet dhe qëllimet e Strategjisë. Ato duhet të informohen nëpërmjet përditësimeve dhe raporteve periodike për të siguruar që ato janë të vetëdijshme dhe të informuara për çështjet përkatëse, por jo përmes angazhimit intensiv. Në këtë kuadrat ka institucione të nivelit të lartë si Zyra e Presidentit të Kosovës, Avokati i Popullit, Kuvendi apo mediat, sepse ato kanë fuqi të mjaftueshme për të ndikuar dhe për shtyrë proceset përpara, por duhet të tërheqin vëmendjen drejt aktiviteteve avokuese të OIK–ut dhe t'u bashkohen nismave.

Fuqi e ulët/interesi i lartë: Këto palë të interesit nuk kanë fuqi dhe ndikim të drejtpërdrejtë vendimmarrës, por ato tregojnë një mbështetje dhe interes të lartë për kauzën e OIK–ut. Mbështetja e tyre është e vlefshme për t'i forcuar përpjekjet e avokimit dhe ato duhet të angazhohen nëpërmjet përditësimeve, buletineve dhe fushatave të përbashkëta për t'i mbajtur ato të përfshira dhe të motivuara. Subjektet dhe organet që ndajnë të njëjtin interes me atë të Odës, por që nuk kanë kompetencë vendimmarrëse, si QKUK, institucionet shëndetësore, anëtarët e OIK–ut universitetet apo shoqatat profesionale, janë pjesë e këtij kuadrati.

Fuqi e ulët/interesi i ulët: Këto palë të interesit kanë ndikim dhe interes të kufizuar për çështjet e ngritura nga Strategjia e Avokimit të OIK–ut. Megjithatë, ato duhet të monitorohen rregullisht dhe është ende e rëndësishme të mbahen të informuara dhe të lidhura, pasi mund të jenë pjesë e bashkëpunimit të ardhshëm dhe të ndikojnë në nismat e ardhshme avokuese. Entitetet e pakta të jashtme si donatorët apo organizatat e ndryshme joqeveritare nuk mund të ndikojnë në nivelin e dëshiruar dhe në të njëjtën kohë nuk janë të interesuar drejtpërdrejt dhe ngushtë për temat e avokimit të OIK–ut.

Hartëzimi i palëve të interesit ofron një paraqitje të qartë dhe vizuale të palëve të ndryshme të interesit dhe pozicioneve të tyre, gjë që ndihmon në përcaktimin dhe hartimin e strategjisë së angazhimit për të komunikuar dhe bashkëpunuar me secilën prej tyre.

Hapi i fundit i këtij procesi është plani i angazhimit të palëve të interesit, i cili përcakton nivelin e angazhimit që çdo palë e interesit do të ketë gjatë zbatimit të Strategjisë, si dhe mënyrën se si Oda do të komunikojë me secilin grup për zbatimin efektiv të Strategjisë dhe përmirësimin e vendimmarrjes.

PLANI I ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT

Palët e interesit	Roli dhe interesat kryesore	Objektivat e angazhimit	Strategjitë e angazhimit	Shpeshtësia	Përgjegjësia
Ministria e Shëndetësisë	Zhvillimi i politikave në lidhje me standardet shëndetësore dhe të kujdesit shëndetësor	Sigurimi i përkushtimit dhe angazhimit të MSH-së në përpjekjet e avokimit të OIK-ut	Organizimi i takimeve të rregullta, përmbledhjet e politikave dhe dokumente të qëndrimeve, raporteve, zhvillimi i punëtorive të përbashkëta	Mujore	Departamenti i Avokimit
Qendra Klinike Universitare e Kosovës	Ofruesi kryesor i kujdesit shëndetësor me interes kryesor për profesionistët e kujdesit shëndetësor	Përafrimi i objektivave të avokimit të OIK-ut me qëllimet e QKUK-së	Planifikimi dhe organizimi i nismave të përbashkëta, shkëmbimeve dhe përditësimeve të ndikimit të avokimit	Çdo dy javë	Departamenti i Avokimit
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	Zhvillimi i politikave dhe standardeve lidhur me arsimin	Krijimi dhe zhvillimi i angazhimit të MASHTI-t për procesin adekuat të akreditimit dhe njohjen e profileve të kujdesit shëndetësor	Organizimi i punëtorive të përbashkëta, prezantimi i përmbledhjeve dhe deklaratave të politikave, raporteve, zhvillimi i takimeve me MASHTI-n dhe palët përkatëse të interesit (AKA, MSH)	Çdo tremujor (çdo 3 muaj)	Departamenti i Avokimit

Agjencia Kosovare e Akreditimit	Sigurimi i cilësisë në institucionet e arsimit të lartë dhe programet e tyre të studimit, duke përfshirë akreditimin dhe riakreditimin	Shtytja e AAK-së në koordinim më të ngushtë me MSH-në dhe MASHTI-n për procesin e duhur të akreditimit të profileve të kujdesit shëndetësor	Organizimi i punëtorive të përbashkëta, shkëmbimi i raporteve dhe deklaratave të politikave, raporteve, realizimi i takimeve me MASHTI-n dhe palët përkatëse të interesit (AKA, MSH)	Çdo tremujor (çdo 3 muaj)	Departamenti i Avokimit
Zyra e Kryeministrit	Organ ekzekutiv dhe drejtues në prioritizimin e politikave në vend	Rritja e ndërgjegjësimit dhe informimi për situatën, nevojat, shqetësimet e profesionistëve të kujdesit shëndetësor	Ndarja e raporteve dhe përditësimeve të politikave, pjesëmarrja në takime të nivelit të lartë dhe organizimi i konferencave të nivelit kombëtar	Sipas nevojës	Departamenti i Avokimit
Kuvendi i Kosovës	Drejtimi i proceseve legjislative	Angazhimi i Kuvendit që të përkushtohet për prioritizimin dhe ndikimin në legjislacionin që ka të bëjë me shëndetin	Ndarja e raporteve dhe përditësimeve, organizimi i takimeve me komisionet e Kuvendit për çështje specifike, zhvillimi i konferencave të përbashkëta, tryezave të rrumbullakëta	Sipas nevojës	Departamenti i Avokimit

Presidenca e Kosovës	Institucioni udhëheqës kombëtar me ndikim në shoqëri dhe në organet vendimmarrëse	Sigurimi i mbështetjes së Presidentit që të angazhohet dhe t'i promovojë iniciativat e kujdesit shëndetësor të synuara dhe të mbështetura nga OIK-u	Ndarja e raporteve dhe përditësimeve, organizimi i takimeve me Presidentin, ftesa në panele, koordinimi për iniciativat për rritjen e ndërgjegjësimit	Sipas nevojës	Departamenti i Avokimit
Institucioni i Avokatit të Popullit	Organi kombëtar për avokimin e përgjithshëm për të drejtat e njeriut dhe publikun si dhe për llogaridhënien	Angazhimi i Avokatit të Popullit që të promovojë dhe të rrisë transparencën dhe llogaridhënien në sektorin e kujdesit shëndetësor	Ndarja e raporteve për çështje të ndryshme, organizimi i takimeve, konferencave të përbashkëta dhe angazhimi në aktivitete dhe fushata të përbashkëta ndërgjegjëse	Sipas nevojës	Departamenti i Avokimit
Anëtarët e OIK-ut	Përfaqësimi i infermierëve, mamive dhe profesionistëve shëndetësorë në nivel kombëtar	Informimi në mënyrë aktive, edukimi dhe përfshirja aktive në diskutim, pjesëmarrja aktive dhe bashkëpunimi i ngushtë për të nxitur iniciativat e avokimit	Ndarja dhe shkëmbimi i rregullt i informacioneve për zhvillimet e fundit, shpërndarja e gazetave të rregullta, organizimi i takimeve të rregullta	Javore	Departamenti i Avokimit

Media	Rritja e ndërgjegjësimit të publikut të përgjithshëm dhe shpërndarja e informacionit	Partneriteti dhe angazhimi i medias në më shumë vëmendje ndaj çështjeve të lidhura me kujdesin shëndetësor dhe në rritjen e ndërgjegjësimit publik për qëllimet e avokimit të OIK-ut	Shpërndarja e njoftimeve të rregullta për shtyp, organizimi i konferencave mediatike dhe ngjarjeve mediatike, shpërndarja e rregullt e fushatave në faqet e internetit dhe rrjetet sociale, koordinimi me gazetarët për praninë e programeve televizive dhe radiofonike	Mujore	Departamenti i Komunikimit/PR
Universitetet	Edukimi i brezave dhe trajnimi i profesionistëve të ardhshëm të kujdesit shëndetësor	Rritja e bashkëpunimit dhe angazhimit për zhvillimin profesional, profilizimin e profesioneve të kujdesit shëndetësor, zhvillimin e kurrikulës së profesionistëve të kujdesit shëndetësor	Organizimi i punëtorive të përbashkëta, zhvillimi i nismave të përbashkëta avokuese dhe takimet me palët e interesit	Tremujore	Departamenti i Avokimit
Shoqatat profesionale	Avokimi për profesionistët në fushën e kujdesit shëndetësor	Përafrimi i pozicioneve dhe përpjekjet për mbështetje dhe avokim të ndërsjellë	Organizimi i fushatave të përbashkëta ndërgjegjëse, takimi dhe shkëmbimi i rregullt mbi zhvillimet për të përditësuar njëri-tjetrin, organizimi i nismave të përbashkëta avokuese	Mujore	Departamenti i Avokimit

Donatorët	Sigurimi i mbështetjes financiare për organizata, institucione dhe iniciativa të ndryshme	Angazhimi për të përfituar dhe siguruar fonde dhe mbështetje për programet e avokimit të OIK-ut	Shkrimi i propozimeve për grante, ndarja e raporteve dhe qëndrimeve, kërkimi i takimeve me donatorët për të kërkuar mbështetje më të madhe financiare	Sipas nevojës	Departamenti i Avokimit / Mbledhja e fondeve
Organizatat e Shoqërisë Civile	Rritja e ndërgjegjësimit, angazhimit dhe mbështetjes së komunitetit për iniciativat e kujdesit shëndetësor	Vendosja e bashkëpunimit, ndërtimi i koalicioneve dhe partneriteteve të forta për iniciativa avokuese me ndikim	Organizimi i fushatave të përbashkëta ndërgjegjëse, i deklaratave të përbashkëta, angazhimi në nisma të përbashkëta avokuese dhe takime me palët e interesit	Mujore	Departamenti i Avokimit
Koordinatorët rajonalë për zhvillim profesional	Ofrimi i mbështetjes për trajnimin dhe zhvillimin profesional të profesionistëve të kujdesit shëndetësor	Nxitja për angazhimin në rritjen e përpjekjeve midis anëtarëve të OIK-ut për të rritur veprimet e avokimit	Shkëmbimi dhe shpërndarja e rregullt e përditësimeve, organizimi i takimeve për të gjeneruar çështje nga terreni dhe për të mbledhur të dhëna për të rritur avokimin	Mujore	Departamenti i Avokimit

Institucionet e edukimit shëndetësor në nivel fillor, të mesëm dhe terciar	Sigurimi i zhvillimit profesional dhe trajnimit të profesionistëve të ardhshëm të kujdesit shëndetësor	Përfshirja dhe angazhimi në iniciativa avokuese që lidhen me kurrikulën dhe zhvillimin profesional të profesionistëve shëndetësorë	Ndarja dhe shkëmbimi për çështje të ndërlidhura me interes të përbashkët, organizimi i punëtorive me partnerë të tjerë, përfshirja në veprime të përbashkëta avokuese	Mujore	Departamenti i Avokimit / Mbledhja e fondeve
--	--	--	---	--------	--

AUDIENCA

Audienca parësore dhe ajo dytësore janë vendimtare për ndikimin e Strategjisë së Avokimit dhe arritjen e objektivave të saj. Gjatë gjithë zbatimit të Strategjisë, komunikimi dhe mesazhet duhet të përshtaten me objektivin specifik për të qenë më efektiv dhe për të tërhequr vëmendjen. Kur mesazhet përputhen me atë që i intereson audiencës specifike, nivelet e angazhimit rriten ndjeshëm. Prandaj, është thelbësore të identifikohet audienca parësore dhe ajo dytësore, si dhe të hartohet një plan specifik komunikimi që targeton segmente të veçanta të audiencës dhe të hartohet në përputhje me nevojat e saj. Audienca parësore dhe ajo dytësore janë të dyja shumë të rëndësishme.

Audienca parësore përfshin vendimmarrësit që kanë autoritetin dhe fuqinë për të sjellë ndryshime politikash ose për të siguruar zbatimin e tyre, ndërsa **audienca dytësore** janë njerëzit, institucionet ose organizatat që mund të ndikojnë në audiencën parësore.

Audienca parësore

- Ministria e Shëndetësisë, e cila është drejtpërdrejt përgjegjëse për politikat dhe shërbimet e shëndetit publik.
- Qendra Klinike Universitare e Kosovës, si institucioni kryesor mjekësor në vend.
- Zyra e Kryeministrit, që është autoriteti qendror për politikëbërjen kombëtare.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, e cila mbikëqyr politikat arsimore që ndikojnë në edukimin shëndetësor.
- Kuvendi i Kosovës, i cili është organi legjislativ përgjegjës për miratimin e legjislacionit.
- Agjencia Kosovare e Akreditimit, e cila siguron cilësi në arsim dhe shëndetësi, në përputhje me standardet.

Audienca dytësore

- Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, si organ që fokusohet në të drejtat e njeriut dhe llogaridhënien.
- Presidenca e Kosovës, si organ drejtues ekzekutiv që ndikon në politika.
- Mediat, si një organ i pazëvendësueshëm për të rritur ndikimin, për t'i përforcuar mesazhet avokuese dhe për të ndërgjegjësuar publikun.
- Universiteti i Prishtinës, si institucion arsimor fillor, i cili mund të veprojë si një mbështetje e rëndësishme në avokim.
- Shoqatat profesionale që përfaqësojnë profesione të ndryshme, si partnerë kryesorë për krijimin e partneriteteve dhe koalicioneve.
- Organizatat që ndajnë të njëjtin mision e që mund të ofrojnë mbështetje për iniciativat të ndryshme avokuese për t'i nxitur proceset vendimmarrëse.
- Donatorët, si objekt kryesor për të siguruar mbështetje financiare për iniciativat e avokimit, duke siguruar qëndrueshmërinë dhe konsistencën e veprimeve avokuese.
- Anëtarët e Odës, të cilët janë profesionistë shëndetësorë të përfshirë në kujdesin ndaj pacientëve dhe mund të veprojnë me rëndësi vendimtare për fuqizimin e veprimeve avokuese të OIK–ut.
- Koordinatorët rajonalë për zhvillim profesional, që lehtësojnë trajnimin dhe zhvillimin, të cilët mund të sigurojnë rrjedhje të menjëhershme të informacionit ndërmjet profesionistëve të fushës dhe organeve të Odës.
- Institucionet e edukimit shëndetësor (fillore, të mesme, terciare), si organe vendimtare për zhvillimin e profesionistëve, të përfshirë kryesisht në zbatim.

Plani i komunikimit

Komunikimi me audiencat specifike, siç përkufizohet më sipër, është esencial për të siguruar që mesazhi ka arritur dhe është perceptuar saktë nga audiencia specifike. Përmbajtja e mesazhit është shumë e rëndësishme, por të njëjtën rëndësi kanë edhe faktorët e tjerë joverbalë: ideja që përcjell mesazhi, mënyra se si përçohet, besueshmëria e tij dhe koha kur shpërndahet.

Përzgjedhja e metodave dhe teknikave më të përshtatshme për të komunikuar me audiencia/palë të veçanta interesi mundëson kuptimin e tyre të saktë për çështjen e avokimit, rrit nivelin e tyre të informacionit për çështjen përkatëse dhe rrit mundësinë e angazhimit dhe mbështetjes së tyre ndaj çështjes me interes. Për të komunikuar saktë dhe për të pasur angazhimin dhe mbështetjen e audiencës, është e rëndësishme të merrni në konsideratë hapat e mëposhtëm, në mënyrë që të tërhiqni vëmendjen e tyre drejt një teme specifike:

	Informoni	Konsultohuni	Përfshini	Bashkëpunoni	Fuqizoni
Metoda e komunikimit	Informoni/edukoni audiencën përmes komunikimit njëkahësh - pa ftesë për përgjigje.	Merrni më shumë informacion dhe komente kthyesë (feedback) nga audiencia për t'i informuar vendimet. Komunikim i kufizuar dykahësh, duke bërë pyetje, me audiencën që jep përgjigje.	Punë e drejtpërdrejtë me audiencën gjatë gjithë procesit për të siguruar që çështjet dhe shqetësimet janë kuptuar dhe konsiderohen; Komunikim dykahësh ose shumëkahësh. punojnë së bashku për të ndërmarrë veprime.	Partneriteti me audiencën për zhvillimin e vendime të përbashkëta të dakorduara reciprokisht. Komunikim dykahësh ose shumëkahësh me negociata dhe vendimmarrje nga të dyja palët; Audiencat punojnë së bashku për të ndërmarrë veprime.	Forconi audiencën në veçanti çështje për qëllime të vendimmarrjes. Ata janë pajisur që të kontribuojnë në arritjen e rezultateve.
	Fletët e të dhënave, faqet e internetit, buletinet, letrat e drejtpërdrejta, raportet, monitorimet, fjalimet, konferencat, prezantimet publike, njoftimet për shtyp.	Anketa, fokus grupe, tryeza, takime, punëtori, diskutime.	Forume, panele diskutimesh, komitete konsultative, seminare, procese vendimmarrjeje me pjesëmarrje.	Grupe tematike, projekte të përbashkëta, iniciativa apo fushata, krijim i partneriteteve.	Integrimi i palëve të interesit në organet e ndryshme të OIK-ut me qëllim të rritjes së ndikimit të avokimit dhe sigurimit të angazhimit të tyre ndaj veprimit.

RREZIQET KRYESORE LIDHUR ME ZBATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË ZBATIMIT:

Audienca parësore dhe ajo dytësore janë vendimtare për ndikimin e Strategjisë së Avokimit dhe arritjen e objektivave të saj. Gjatë gjithë zbatimit të Strategjisë, komunikimi dhe mesazhet duhet të përshtaten me objektivin specifik për të qenë më efektiv dhe për të tërhequr vëmendjen. Kur mesazhet përputhen me atë që i intereson audiencës specifike, nivelet e angazhimit rriten ndjeshëm. Prandaj, është thelbësore të identifikohet audienca parësore dhe ajo dytësore, si dhe të hartohet një plan specifik komunikimi që targeton segmente të veçanta të audiencës dhe të hartohet në përputhje me nevojat e saj. Audienca parësore dhe ajo dytësore janë të dyja shumë të rëndësishme.

Zbatimi i kësaj strategjie avokuese mund të përballet me rreziqe të mundshme që mund të pengojnë ose vonojnë aktivitetet dhe arritjen e objektivave të parapara. Prandaj, duhet të parashikohen sfidat e mundshme që mund të ndodhin dhe të hartohet një plan zbutës, për t'i shmangur dhe tejkaluar këto barriera.

1. Mungesa ose angazhimi i ulët i palëve të interesit

Rreziku: Bashkëpunimi i pamjaftueshëm me palët kryesore të interesit që mund të çojë në përpjekje joefektive të avokimit.

Plani i zbutjes: Zhvillimi i një plani të angazhimit të palëve të interesit që përfshin konsultime të rregullta, mekanizma të komenteve kthyesë (feedback) dhe aktivitete për ndërtimin e partneritetit me organizatat dhe politikëbërësit përkatës.

2. Rezistenca e palëve të interesit

Rreziku: Palët e interesit, përfshirë zyrtarët e qeverisë, mund t'i rezistojnë ndryshimeve të propozuara në legjislacion ose politika.

Plani i zbutjes: Përgatitja e argumenteve dhe qëndrimeve të bazuara në dëshmi që demonstrojnë përfitimet nga ndryshimet e propozuara. Angazhimi në dialog dhe negociata të vazhdueshme për t'i adresuar shqetësimet dhe për të arritur dakordimin.

3. Keqkuptimi i qëllimeve të avokimit

Rreziku: Komunikimi i gabuar që mund të shkaktojë mungesën e kuptimit të duhur të qëllimeve të avokimit dhe mungesën e mbështetjes për iniciativat e avokimit.

Plani i zbutjes: Zbatimi i një strategjie të fuqishme komunikimi që artikulon qartë misionin, qëllimet dhe përfitimet e përpjekjeve të avokimit. Përdorimi i platformave të ndryshme, duke përfshirë rrjetet sociale, buletinet dhe ngjarjet në komunitet, për të shpërndarë informacionin në mënyrë efektive.

4. Financimi dhe burimet e pamjaftueshme

Rreziku: Burimet e kufizuara financiare mund të pengojnë zbatimin e aktiviteteve të avokimit.

Plani i zbutjes: Krijoni një strategji të larmishme financimi që përfshin tarifën e anëtarësimit, grantet dhe partneritetet me OJQ-të dhe sektorin privat. Kryeni fushata të rregullta për mbledhjen e fondeve dhe eksploroni burimet alternative të financimit.

5. Kapaciteti i brendshëm i pamjaftueshëm

Rreziku: OIK-ut mund t'i mungojnë aftësitë ose ekspertiza e nevojshme për të ekzekutuar në mënyrë efektive strategjinë e tij të avokimit.

Plani i zbutjes: Angazhohuni në aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve për stafin dhe anëtarët. Ofroni trajnime mbi teknikat e avokimit, aftësitë e komunikimit dhe analizën e politikave për të rritur efektivitetin.

6. Ndryshimet në mjedisin e kujdesit shëndetësor

Rreziku: Ndryshimet e shpejta në mjedisin e kujdesit shëndetësor mund të vjetërsojnë qëllimet ose aktivitetet e avokimit.

Plani i zbatjes: Monitoroni në mënyrë të vazhdueshme mjedisin e kujdesit shëndetësor, ndiqni zhvillimet e fundit dhe rregulloni Strategjinë e Avokimit në përputhje me rrethanat.

OBJEKTIVAT, REZULTATET E PRITSHME DHE AKTIVITETET E STRATEGJISË SË AVOKIMIT TË OIK–ut:

OBJEKTIVI 1: Ndërtimi dhe fuqizimi i kapaciteteve dhe aftësive të OIK–ut për të avokuar në mënyrë efektive për mbrojtjen e interesave të profesionistëve shëndetësorë dhe avancimin e rolit dhe pozitës së tyre në sektorin e kujdesit shëndetësor.

Rezultatet e pritshme:

Rezultati i pritshëm 1: Rritja e kompetencave dhe besimit të OIK–ut në aktivitetet e avokimit për të ndikuar në politikat e dobishme për profesionistët e kujdesit shëndetësor.

Rezultati i pritshëm 2: Rritja e angazhimit të OIK–ut dhe anëtarëve të tij në përpjekjet e avokimit për të rritur nivelin e pjesëmarrjes në proceset e politikëbërjes.

Aktivitetet:

Aktiviteti 1: Zhvillimi i një manuali gjithëpërfshirës për ngritjen e kapaciteteve mbi avokimin dhe komunikimin dhe shpërndarja e tij tek të gjithë anëtarët.

Aktiviteti 2: Organizimi i katër webinarëve të sesioneve informative, mbi manualin e ngritjes së kapaciteteve, për aftësitë e avokimit dhe komunikimit të përshtatura me nevojat e profileve të përfaqësuara në OIK.

Aktiviteti 3: Zhvillimi i një Strategjie Komunikimi për të përmirësuar komunikimin efektiv të mesazheve avokuese tek palët e interesit dhe audienca më e gjerë.

Aktiviteti 4: Organizimi i tri punëtorive të specializuara 2–ditore për koordinatorët e secilit profil për t'i forcuar aftësitë e tyre drejtuese dhe avokuese.

Aktiviteti 5: Zhvillimi i një Strategjie gjithëpërfshirëse për mbledhjen e fondeve për t'i diversifikuar burimet financiare dhe për të rritur qëndrueshmërinë drejt avokimit efektiv.

Aktiviteti 6: Organizimi i një trajnimi 2–ditor për OIK–un për t'i rritur kapacitetet dhe aftësitë për mbledhjen e fondeve.

Aktiviteti 7: Zhvillimi dhe zbatimi i një manuali të mentorimit që bashkon avokuesit me përvojë me anëtarë me më pak përvojë, duke u fokusuar në ndërtimin e besimit dhe shkëmbimin e praktikave më të mira.

Aktiviteti 8: Organizimi i dy vizitave studimore çdo vit, në organizata, rrjete ose rajone me modele të suksesshme avokimi, për t'i marrë praktikën më të mira mbi strategjitë dhe qasjet efektive.

Aktiviteti 9: Organizimi i dy forumeve ose tryezave të rrumbullakëta të diskutimit çdo vit, ku anëtarët mund të japin informata mbi çështjet e politikave, t'i ndajnë njohuritë e tyre dhe të bashkëpunojnë në veprimet e avokimit.

Aktiviteti 10: Zhvillimi dhe zbatimi i një mekanizmi të strukturuar të komenteve kthyes (feedback) (anketë vjetore) për të mbledhur të dhëna të anëtarëve mbi iniciativat e avokimit dhe për t'i identifikuar nevojat ose çështjet e mëtejshme për të cilat duhet avokuar.

OBJEKTIVI 2: Të kontribuojë në përmirësimin dhe avancimin e kornizës ligjore që prek interesin e profesionistëve shëndetësorë, përmes rritjes së ndikimit në proceset e vendimmarrjes dhe formësimit të politikave.

Rezultatet e pritshme:

Rezultati i pritshëm 1: Forcimi i rolit të OIK–ut në proceset vendimmarrëse, për të avancuar dhe përmirësuar kornizën ligjore që ndikon pozitivisht tek profesionistët shëndetësorë.

Rezultati i pritshëm 2: Marrëdhënia me palët kryesore të interesit është përmirësuar, për të lehtësuar dialogun e vazhdueshëm dhe ndikimin në politikën e kujdesit shëndetësor.

Aktivitetet:

Aktiviteti 1: Përgatitja e përmbledhjeve të politikave dhe dokumenteve të qëndrimeve për të prezantuar dhe ndarë qëndrimin e OIK–ut në lidhje me Ligjin për Shëndetësinë dhe Ligjin e ri për Infermierët dhe çështje të tjera.

Aktiviteti 2: Zhvillimi dhe publikimi i raporteve vjetore të monitorimit që analizojnë peizazhin ligjor që prek profesionistët shëndetësorë, duke theksuar fushat për përmirësim dhe rekomandime për ndryshime politikash.

Aktiviteti 3: Organizimi i takimeve dhe tryezave të diskutimit me MSH–në dhe MASHTI–n për t'i adresuar mospërputhjet në akreditimin e profileve të reja të profesionistëve shëndetësorë dhe për t'u siguruar që ato të njihen në kornizën ligjore.

Aktiviteti 4: Zhvillimi dhe nisja e një fushate ndërgjegjësimi që mbron krijimin e një ligji të ri specifik për infermierët, duke përfshirë rritjen e mbështetjes nga anëtarët dhe palët e interesit për të ndërtuar një rrjet për këtë iniciativë.

Aktiviteti 5: Organizimi i dy tryezave të rrumbullakëta çdo vit me politikëbërësit në nivel qendror dhe lokal për t'i diskutuar çështjet përkatëse të kujdesit shëndetësor, përfshirë Ligjin për Shëndetësinë, Ligjin e ri për Infermierët dhe përafrimin e klasifikimeve të vendeve të punës me direktivat e BE–së.

Aktiviteti 6: Krijimi i kanaleve të rregullta të komunikimit (buletinet, përditësimet) për t'i mbajtur palët e interesit të informuara për aktivitetet e OIK–ut, progresin në përpjekjet e avokimit dhe çështjet e reja ligjore që prekin profesionistët e kujdesit shëndetësor.

OBJEKTIVI 3: Rritja e informimit dhe edukimit të publikut mbi rolin vendimtar të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe rëndësinë e tyre në sigurimin e shëndetit dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve.

Rezultatet e pritshme:

Rezultati i pritshëm 1: Rritja e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit nga publiku sa i përket rolit të profesionistëve shëndetësorë, për të promovuar kontributin e tyre në shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve.

Rezultati i pritshëm 2: Rritja e mbulueshmërisë mediatike dhe promovimi i rëndësisë së profesionistëve shëndetësorë, për të përmirësuar perceptimin dhe qëndrimin e publikut ndaj profesionistëve shëndetësorë.

Aktivitetet:

Aktiviteti 1: Organizimi dhe zbatimi i fushatës vjetore ndërgjegjësuere dhe informuese mbi kontributin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë infografikë, video dhe dëshmi që tregojnë rolin e profesionistëve shëndetësorë.

Aktiviteti 2: Organizimi i fushatave në rrjete sociale në ditët ndërkombëtare që shënohen për profesionistët e kujdesit shëndetësor, për të informuar dhe edukuar publikun e gjerë për rëndësinë e tyre, duke përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e broshurave dhe fletushkave që shpjegojnë rolet e profesionistëve shëndetësorë dhe ndarjen e posterave online me personalitete të njohura që i bashkohen fushatave në rrjete sociale.

Aktiviteti 3: Zgjerimi i bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar të OIK–ut me organet përkatëse në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përmes memorandumit të mirëkuptimit ose marrëveshjeve, për të rritur ndikimin e veprimeve dhe iniciativave të përbashkëta.

Aktiviteti 4: Pasurimi dhe avancimi i faqes së internetit të OIK–ut me komponentë dhe materiale të reja, lehtësimi i një komunikimi më efektiv dhe efikas me anëtarët, palët e interesit dhe audiencën më të gjerë.

Aktiviteti 5: Krijimi dhe zhvillimi i një podcasti të dedikuar duke sjellë vendimmarrës, profesionistë, palë kryesore të interesit, pacientë, etj., për ndarjen e lajmeve, ngjarjeve të suksesit dhe iniciativave të ndërmarra nga OIK–u.

Aktiviteti 6: Zhvillimi dhe shpërndarja e të paktën tri njoftimeve për shtyp në vit për mbulim mediatik, duke theksuar rëndësinë e profesionistëve shëndetësorë dhe çështje të tjera relevante për OIK–un.

Aktiviteti 7: Organizimi i të paktën tri konferencave për shtyp në vit për t'i shpallur dhe ndarë iniciativat ose qëndrimet e OIK–ut për çështje specifike që prekin anëtarët.

Aktiviteti 8: Rritja e shtrirjes tek publiku dhe e përmendjes mediatike të aktivitetit të OIK–ut, me 500 mijë qasje në internet dhe të paktën 100 përmendje mediatike në vit, mbi aktivitetet dhe fushatat e Odës.

PLANI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Objektivi 1: Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve dhe aftësive të OIK-ut për të avokuar në mënyrë efektive për mbrojtjen e interesave të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe avancimin e rolit të tyre në sektorin e kujdesit shëndetësor.												
Rezultati i pritshëm	Aktiviteti	Treguesi	Gjendja aktuale (janar 2025)	Synimi (dhjetor 2029)	Mjetet e verifikimit	2025	2026	2027	2028	2029	Përgjegjës	Buxheti
RP 1: Kompetencat e OIK-ut në aktivitetet e avokimit janë rritur, për të ndikuar politikat me rëndësi për profesionistët e kujdesit shëndetësor.	Aktiviteti 1: Zhvillimi dhe shpërndarja tek të gjithë anëtarët, e një manuali gjithëpërfshirës mbi legjislacionin, aktet normative dhe Kodin e Etikës së OIK-ut.	Numri i manualeve të zhvilluara	0 manuale	1 manual	Dokumenti i manualit	X						
	Aktiviteti 2: Organizimi i të paktën tri punëtorive specifike 2-ditore për koordinatorët e çdo profili, për t'i forcuar aftësitë e tyre drejtuese dhe avokuese.	Numri i punëtorive të mbajtura	0 punëtori të mbajtura	Të paktën 3 punëtori 2-ditore	Ftesa, agjenda, lista e pjesëmarrësve, fotot, raportet	X	X					
		Numri i pjesëmarrësve	0 pjesëmarrës	Të paktën 90 pjesëmarrës								
	Aktiviteti 3: Zhvillimi i një plani gjithëpërfshirës për identifikimin e partnerëve bashkëpunues, për t'i zhvilluar dhe rritur më tej kapacitetet e OIK-ut.	Numri i planeve të zhvilluara	0 plane	1 plan gjithëpërfshirës	Dokumenti me planin gjithëpërfshirës		X					

RP 2: Angazhimi i OIK-ut dhe anëtarëve të tij në përpjekjet e avokimit është rritur, për të rritur nivelin e pjesëmarrjes dhe ndikimin në proceset e politikëbërjes.	Aktiviteti 4: Organizimi i të paktën një vizite studimore çdo vit, në organizata, rrjete ose rajone me modele të suksesshme avokimi, për t'i marrë praktikën më të mira mbi strategjitë dhe qasjet efektive.	Numri i vizitave studimore	0 vizita studimore	Të paktën 5 vizita studimore	Ftesa, agjenda, fotot, lista e pjesëmarrësve, dokumentet e udhëtimit, raportet e vizitave	X	X	X	X	X		
		Numri i pjesëmarrësve	0 pjesëmarrës në vizita studimore	Të paktën 30 pjesëmarrës në vizita studimore								
		Numri i praktikave të përbashkëta/fituara	0 praktika të fituara	Të paktën 20 praktika të fituara								
	Aktiviteti 5: Organizimi i tryezave të rrumbullakëta çdo vit, ku anëtarët mund të ofrojnë të dhëna për t'i shtyrë përpara çështjet e politikave, t'i ndajnë njohuritë e tyre dhe të bashkëpunojnë në veprimet e avokimit.	Numri i tryezave	0 tryeza	Të paktën 10 tryeza	Ftesa, agjenda, fotot, lista e pjesëmarrësve, dokumentet e zhvilluara	X	X	X	X	X		
		Numri i raporteve/deklaratave të zhvilluara	0 produkte	Të paktën 10 produkte								

Objektivi 2: Dhënia e kontributit në përmirësimin dhe avancimin e kornizës ligjore që ndikon në interesin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor, përmes rritjes së ndikimit në proceset e vendimmarrjes dhe hartimit të politikave.

Rezultati i pritshëm	Aktiviteti	Treguesi	Gjendja aktuale (janar 2025)	Synimi (dhjetor 2029)	Mjetet e verifikimit	2025	2026	2027	2028	2029	Përgjegjës	Buxheti
RP 1: Roli i OIK-ut në proceset vendimmarrëse është rritur, për të avancuar dhe përmirësuar kornizën ligjore që ndikon tek profesionistët e kujdesit shëndetësor.	Aktiviteti 1: Përgatitja e përmbledhjeve të politikave dhe letrave të qëndrimeve për të ndarë qëndrimin e OIK-ut për Ligjin për Shëndetësinë, Ligjin për Infermierët dhe proceset e tjera legjislative që mund të iniciohen.	Numri i përmbledhjeve të politikave dhe letrave të qëndrimeve	0 përmbledhje politikash	Të paktën 10 përmbledhje politikash	Dokumentet e përmbledhjeve të politikave	X	X	X	X	X		
			0 letra qëndrimesh	Të paktën 10 letra qëndrimesh	Dokumentet e letrave të qëndrimeve							
	Aktiviteti 2: Zhvillimi dhe publikimi i raporteve vjetore të monitorimit që analizojnë peizazhin ligjor që prek profesionistët e kujdesit shëndetësor, duke theksuar fushat për përmirësim dhe rekomandimet për ndryshime politikash.	Numri i raporteve vjetore të monitorimit	0 raporte monitorimi	Të paktën 4 raporte monitorimi	Dokumentet e raporteve të monitorimit	X	X	X	X	X		

	Aktiviteti 3: Organizimi i takimeve/tryezave të diskutimit me MSH-në, MASHTI-n dhe Agjencinë Kosovare për Akreditim, për t'i adresuar mospërputhjet në akreditimin e profileve të reja të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe për t'u siguruar që ato njihen në kornizën ligjore.	Numri i tryezave/takimeve	0 takime/tryeza	6 takime/tryeza	Ftesa, agjenda, fotot, lista e pjesëmarrësve, dokumentet e zhvilluara, raportet	X	X	X				
		Numri i akterëve të angazhuar	0 akterë të angazhuar	30 akterë të angazhuar								
	Aktiviteti 4: Zhvillimi dhe nisja e një fushate ndërgjegjësuere për krijimin e Ligjit për Infermierët, për të mbledhur mbështetjen nga anëtarët dhe palët e interesit për këtë nismë.	Numri i fushatave ndërgjegjësuere për Ligjin për Infermierët	0 fushata ndërgjegjësuere për Ligjin për Infermierët	1 fushatë ndërgjegjësuere për Ligjin për Infermierët	Fotot, posterat, njoftimet për shtyp		X	X				
RP 2: Marrëdhëniet me akterët kryesorë janë përmirësuar, për të lehtësuar dialogun e vazhdueshëm dhe ndikimin në politikat e lidhura me kujdesin shëndetësor.	Aktiviteti 5: Organizimi i të paktën një tryeze të rumbullakët çdo vit me politikëbërësit në nivel qendror dhe lokal, për të diskutuar çështjet e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë Ligjin për Shëndetësinë, Ligjin për Infermierët, përafrimin e klasifikimeve të vendeve të punës me direktivat e BE-së, dhe të tjera.	Numri i tryezave	0 tryeza	Të paktën 5 tryeza	Ftesa, agjenda, fotot, lista e pjesëmarrësve, raportet, deklaratat me rekomandime	X	X	X	X	X		
		Numri i politikëbërësve	0 politikëbërës	Të paktën 50 politikëbërës								
		Numri i rekomandimeve të avokuara	0 rekomandime të avokuara	Të paktën 20 rekomandime të avokuara								

Objektivi 3: Rritja e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë për rolin vendimtar të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe rëndësinë e tyre në sigurimin e shëndetit dhe mirëqenies së gjithë qytetarëve.

Rezultati i pritshëm	Aktiviteti	Treguesi	Gjendja aktuale (janar 2025)	Synimi (dhjetor 2029)	Mjetet e verifikimit	2025	2026	2027	2028	2029	Përgjegjës	Buxheti
RP 1: Ndërgjegjësimi publik dhe kuptimi i rolit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor, është rritur, për të promovuar kontributin e tyre në shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve.	Aktiviteti 1: Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere dhe informuese për rolin e OIK-ut në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, në respektimin e Kodit të Etikës, në respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve në sistemin shëndetësor.	Numri i fushatave ndërgjegjësuere/informative	0 fushata ndërgjegjësuere/informative	Të paktën 5 fushata ndërgjegjësuere/informative	Lista e pjesëmarrësve, fotot, posterat, njoftimet/komunikatat për shtyp	X	X	X	X	X		
	Aktiviteti 2: Organizimi i fushatave në rrjete sociale, në ditët ndërkombëtare të shënuara për profesionistët e kujdesit shëndetësor, për të informuar dhe edukuar publikun e gjerë për rëndësinë e tyre, duke përfshirë shpërndarjen e broshurave, fletushkave dhe shpërndarjen e posterave online në rrjetet sociale.	Numri i fushatave në rrjetet sociale	0 fushata në rrjetet sociale	Të paktën 100 fushata në rrjetet sociale	Fotot, posterat, broshurat, fletushkat, njoftimet për shtyp, lista me ditët ndërkombëtare për t'u shënuar	X	X	X	X	X		

	Aktiviteti 3: Zgjerimi i bashkëpunimit të OIK-ut me organet përkatëse në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, nëpërmjet memorandumit të mirëkuptimit ose marrëveshjeve, për të shfrytëzuar ndikimin e veprimeve dhe nismave të përbashkëta. ¹	Numri i MM të nënshkruara	0 MM të nënshkruara	Të paktën 8 MM të nënshkruara	Dokumentet e MM, lista e partnerëve të rinj	X	X	X	X	X		
		Numri i nismave të përbashkëta avokuese	0 nisma të përbashkëta	Të paktën 15 nisma të përbashkëta	Raportet, dokumentet për nisma të përbashkëta							
	Aktiviteti 4: Pasurimi dhe avancimi i faqes së internetit të OIK-ut me komponentë dhe materiale të reja, për të lehtësuar një komunikim më efektiv dhe efikas me anëtarët, palët e interesit dhe audiencën e gjerë. ²	Numri i veçorive të reja të inkuorpuara në faqen e internetit	0 veçori të reja	Të paktën 5 veçori të reja	³ Raportet, pamjet e ekranit për veçoritë e reja (anketat, hapësira me video), lista e veçorive, % e rritjes së angazhimit		X	X	X	X		

¹ Në zbatim të objektivit strategjik 5, objektivit specifik 5.3, të Strategjisë Institucionale për Odën e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësor.

² Në zbatim të objektivit strategjik 5, objektivit specifik 5.3, të Strategjisë Institucionale për Odën e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësor.

³ Në zbatim të objektivit strategjik 5, objektivit specifik 5.3, të Strategjisë Institucionale për Odën e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësor.

MATRICA VJETORE E MONITORIMIT

OBJEKTIVI STRATEGJIK: Avancimi i pozitës së Odës në ndikimin e proceseve legislative dhe ndërgjegjësimin e publikut për rolin dhe rëndësinë e infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë, për ofrimin e shërbimit shëndetësor cilësor për qytetarët.							
Objektivi 1: Ndërtimi dhe forcimi i kapaciteteve dhe aftësive të anëtarëve të OIK-ut për të avokuar në mënyrë efektive për mbrojtjen e interesave të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe avancimin e rolit dhe pozitës së tyre në sektorin e kujdesit shëndetësor.	Treguesi	Mjetet e verifikimit	Njësia	Gjendja aktuale	Synimi		Shpeshtësia e raportimit
					6 muaj	Viti 1	
Rezultati i pritshëm 1: Kompetencat dhe besimi i OIK-ut në aktivitetet e avokimit janë rritur, për të ndikuar në politikat e dobishme për profesionistët e kujdesit shëndetësor.	Përqindja e anëtarëve të OIK-ut me aftësi të përmirësuara avokuese përmes vlerësimit para dhe pas trajnimit	Anketat që vlerësojnë aftësitë e tyre para dhe pas trajnimit	%	0%		70%	Vjetore
Aktiviteti 1: Zhvillimi dhe shpërndarja tek të gjithë anëtarët e një manuali gjithëpërfshirës mbi legjislacionin, aktet normative dhe Kodin e Etikës të OIK-ut.	Numri i manualeve të shpërndara	Lista e shpërndarjes	Manual	0	1		Pas 6 muajsh
Aktiviteti 2: Organizimi i tri seminareve të specializuara 2-ditore për koordinatorët e secilit profil për t'i forcuar aftësitë e tyre drejtuese dhe avokuese.	Numri i seminareve të zhvilluara	Ftesa, agjenda, raportet, fotot	Seminar	0		2	Vjetore
	Numri i koordinatorëve të trajnuar	Listat pjesëmarrësve	Koordinator	0		60	

Rezultati i pritshëm 2: Rritja e angazhimit të OIK-ut dhe anëtarëve të tij në përpjekjet e avokimit, për të rritur nivelin e pjesëmarrjes në proceset e politikëbërjes.	Numri i përfaqësuesve të OIK-ut që marrin pjesë në konsultime, diskutime ose takime me politikëbërësit	Dokumenti me prova për pjesëmarrjen e OIK-ut në ngjarje.	Përfaqësues i OIK-ut	0		15	Vjetore
Aktiviteti 4: Organizimi i të paktën një vizite studimore çdo vit, në organizata, rrjete ose rajone me modele të suksesshme avokimi, për të marrë praktikat më të mira mbi strategjitë dhe qasjet efektive.	Numri i vizitave studimore të organizuara	Ftesa, agjenda, fotot, dokumentet e udhëtimit	Vizitë studimore	0		1	Vjetore
	Numri i anëtarëve të OIK-ut pjesëmarrës në vizitë	Lista e pjesëmarrësve	Pjesëmarrës	0		6	
	Numri i praktikave më të mira të fituara nga vizita	Raporti i vizitës studimore me praktikat më të mira të fituara.	Praktika më e mirë	0		4	
Aktiviteti 5: Organizimi i forumeve ose tryezave të rrumbullakëta diskutimi çdo vit ku anëtarët mund të japin inpute për çështjet e politikave, t'i ndajnë njohuritë e tyre dhe të bashkëpunojnë në veprimet e avokimit.	Numri i tryezave të rrumbullakëta të mbajtura	Ftesa, agjenda, raportet, fotot	Forum ose tryezë e rrumbullakët	0		2	Vjetore
	Numri i anëtarëve pjesëmarrës	Lista e pjesëmarrësve	Anëtar	0		20	
	Numri i rekomandimeve të politikave nga diskutimet	Dokumentet e zhvilluara	Rekomandim politikash	0		2	

Objektivi 2: Dhënia e kontributit në përmirësimin dhe avancimin e kornizës ligjore që ndikon në interesin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor, përmes rritjes së ndikimit në proceset vendimmarrëse dhe të formësimit të politikave.	Treguesi	Mjetet e verifikimit	Njësia	Gjendja aktuale	Synimi		Shpeshtësia e raportimit
					6 muaj	Viti 1	
Rezultati i pritshëm 1: Forcimi i rolit të OIK-ut në proceset vendimmarrëse, për të avancuar dhe përmirësuar kornizën ligjore që ndikon pozitivisht tek profesionistët e kujdesit shëndetësor.	Numri i rekomandimeve të OIK-ut që janë të inkorporuara në kornizën ligjore	Dokumentet e ligjeve ose propozimet legjislative ku përfshihet propozimi i OIK-ut	Rekomandim i inkorporuar	0		3	Vjetore
Aktiviteti 1: Përgatitja e përmbledhjeve të politikave dhe letrave të qëndrimeve për të prezantuar dhe ndarë qëndrimin e OIK-ut për Ligjin për Shëndetësinë, Ligjin për Infermierët dhe proceset e tjera legjislative që mund të iniciohen.	Numri i përmbledhjeve të politikave	Dokumenti i përmbledhjeve të politikave	Përmbledhje e politikave	0		2	Vjetore
	Numri i letrave të qëndrimeve	Dokumenti i letrave të qëndrimeve	Letër e qëndrimeve	0		2	
Aktiviteti 2: Zhvillimi dhe publikimi i raporteve vjetore të monitorimit që analizojnë peizazhin ligjor që ndikon në profesionistët e kujdesit shëndetësor, duke theksuar fushat për përmirësim/rekomandimet për ndryshime politikash.	Numri i raporteve vjetore të monitorimit	Dokumenti i raportit të monitorimit	Raport i monitorimit	0		1	Vjetore

Aktiviteti 3: Organizimi i takimeve/tryezave të diskutimit me MSH-në dhe MASHTI-n për t'i adresuar mospërputhjet në akreditimin e profileve të reja të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe për t'u siguruar që ato njihen në kornizën ligjore.	Numri i tryezave/takimeve	Ftesa, agjenda, fotot, raportet	Tryezë e rrumbullakët	0		2	Vjetore
	Numri i palëve të interesit të angazhuara	Lista e pjesëmarrësve	Palë e interesit	0		20	
Rezultati i pritshëm 2: Marrëdhënia me akterët kryesorë e përmirësuar, për të lehtësuar dialogun e vazhdueshëm dhe ndikimin në politikën e kujdesit shëndetësor.	Shpeshtësia e konsultimit ose përfshirjes së OIK-ut në diskutime mbi ligjet apo politikat e kujdesit shëndetësor	Ftesa për OIK-un për të marrë pjesë në diskutime legislative ose politikëbërëse	Diskutim, takim	0		10	Vjetore
Aktiviteti 5: Organizimi i të paktën një tryeze të rrumbullakët çdo vit me politikëbërësit në nivel qendror dhe lokal, për t'i diskutuar çështjet e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë Ligjin për Shëndetësinë, Ligjin për Infermierët, përafrimin e klasifikimeve të vendeve të punës me direktivat e BE-së.	Numri i tryezave	Ftesa, agjenda, fotot, raportet,	Tryezë e rrumbullakët	0		1	Vjetore
	Numri i politikëbërësve	Lista e pjesëmarrësve	Politikbërës	0		20	
	Numri i rekomandimeve të avokuara	Deklarata me rekomandime	Rekomandim i avokuar	0		5	

Objektivi 3: Rritja e informimit dhe edukimit të publikut mbi rolin vendimtar të profesionistëve shëndetësorë dhe rëndësinë e tyre në sigurimin e shëndetit dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve..	Treguesi	Mjetet e verifikimit	Njësia	Gjendja aktuale	Synimi		Shpeshtësia e raportimit
					6 muaj	Viti 1	
Rezultati i pritshëm 1: Rritja e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit nga ana e publikut për rolin e profesionistëve shëndetësorë, për të promovuar kontributin e tyre në shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve.	Përqindja e rritjes së ndërgjegjësimit publik ndaj profesionistëve shëndetësorë	Të dhënat nga anketat që vlerësojnë perceptimet e publikut për profesionistët shëndetësorë	%	0%		10%	Vjetore
Aktiviteti 1: Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere dhe informuese mbi rolin e OIK-ut në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, në respektimin e Kodit të Etikës, të drejtave themelore të njeriut, të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve në sistemin shëndetësor.	Numri i fushatave ndërgjegjësuere/informuese	Lista e pjesëmarrësve, fotot, posterat, njoftimet për shtyp mbi fushatat	Fushata	0		1	Vjetore
Aktiviteti 2: Organizimi i fushatave në rrjete sociale në ditët ndërkombëtare të shënuara për profesionistët e kujdesit shëndetësor, për të informuar dhe edukuar publikun e gjerë për rëndësinë e tyre, me broshura, fletushka dhe postera online në rrjetet sociale.	Numri i fushatave në rrjetet sociale	Fotot, posterat, broshurat, fletushkat, njoftimet për shtyp, lista me ditët ndërkombëtare për t'u shënuar	Fushata në rrjetet sociale	0	15		Pas 6 muajsh

Aktiviteti 3: Zgjerimi i bashkëpunimit të OIK-ut me organet përkatëse në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, nëpërmjet memorandumit të mirëkuptimit ose marrëveshjeve, për të shfrytëzuar ndikimin e veprimeve dhe nismave të përbashkëta.	Numri i Memorandumeve të Mirëkuptimit të nënshkruara	Dokumentet e MM, lista e partnerëve të rinj	Memorandum Mirëkuptimi	0		2	Pas 6 muajsh
	Numri i nismave të përbashkëta avokuese	Raportet, dokumentet për nisma të përbashkëta				2	

